



## REPUBLIKA E SHQIPËRISË

INSTITUTI I SIGURIMEVE  
SHOQËRORE

MINISTRIA E SHËNDETËSISË

# R R E G U L L O R E

Datë 30.05.2005

### **“Për Organizimin, të Drejtat, Detyrat dhe Funksionimin e Komisionit Mjekësor të Caktimit të Aftësisë për Punë të Invalidëve”**

Në mbështetje të Ligjit nr. 7703, date 11.05.1993 “Per Sigurimet Shoqerore në RSH”, të ndryshuar nenet 35, 37, 38, 48, 49 dhe 59 dhe me qellim që të caktohen sa më drejte organizimi, të drejtat, detyrat dhe funksionimi i Komisionit Mjekësor të Caktimit të Aftësisë për Punë të Invalidëve, Instituti i Sigurimeve Shoqerore dhe Ministria e Shëndetësisë nxjerrin këto Rregullore:

#### **I. Organizimi i Komisionit Mjekësor të Caktimit të Aftësisë për Punë të Invalidëve**

1. Komisioni Mjekësor i Caktimit të Aftësisë për Punë të Invalidëve (me poshtë do të quhet KMCAP-i) është organ mjekësor dhe ligjor që e mbështet veprimtarinë e tij në dispozitat e ligjit nr.7703, date 11.5.1993 “Per Sigurimet Shoqerore në Republikën e Shqipërisë” dhe në kriteret mjekësore të caktimit të aftësisë për punë të semureve dhe invalideve. Ai përcakton shkallën e humjes së aftësisë për punë të invalidit dhe rruget që duhen ndjekur për riaftësimin e tij fizik dhe profesional. KMCAP e ushtron aktivitetin e tij në Institutin e Sigurimeve Shoqerore, drejtohet dhe përgjigjet para Institutit të Sigurimeve Shoqerore për aktivitetin që kryen.

2. KMCAP-i Rajonal ngrihet në DRSSH-te dhe në ALSSH për atë kohë sa ky komision nuk është organizuar në nivel rajonal. KMCAP-i Rajonal përbehet nga tre deri në pesë anetare. Anetare të komisioneve zgjidhen mjekë specialiste që punojnë në institucione shtetërore me shtetërore, kanë njohuri shumë të mira në specialitetin e tyre dhe eksperiencë në specialitet jo më pak se pesë vjet. Mjeku i DRSSH-se është anetar i KMCAP-it Rajonal.

Mbështetur në situatën dhe ecurinë e invaliditetit, në DRSSH-te ngrihen edhe KMCAP-et e specializuara.

Mbështetur në strukturën e invaliditetit në qark, anetarët e KMCAP-ve duhet të kenë këto specialitete: Kardiolog, patolog (rheumatolog, nefrolog, pneumoftiziater endokrinolog etj), kirurg, ortoped, neurolog, neurokirurg, psikiater dhe okulist.

Numri, llojet e specialiteteve dhe anetaret e KMCAP-it caktohen nga DRSSH-ja dhe miratohen nga drejtuesit e organit shendetesor qe ka ne varesi specialistin.

KMCAP-i Rajonal fillon aktivitetin e tij pas miratimit nga Instituti i Sigurimeve Shoqerore.

Çdo ndryshim ne KMCAP-in Rajonal, lidhur me llojin e specialitetit dhe numrin e specialisteve behet pas miratimit nga ISSH-ja.

Si rregull, perberja e KMCAP-ve rinovohet çdo pese vjet.

3. KMCAP-et Eprore te specializuara ngrihen dhe funksionojne ne Drejtorine e Pergjithshme te ISSH-se. Numri, llojet e specialiteteve dhe anetaret e komisioneve (mjeke specialiste me grada shkencore), caktohen nga Instituti i Sigurimeve Shoqerore dhe miratohen nga Ministria e Shendetesise.

Anetare te KMCAP-ve Eprore si rregull caktohen shefat e sherbimeve dhe kryetaret e KMCAP-ve Eprore caktohen shefat e departamenteve te cilet ndryshojne automatikisht ne varesi te zgjedhjes ne postet e shefit te sherbimit dhe shefit te departamentit.

4. Ne KMCAP-et Eprore te specializuara dhe KMCAP-et Rajonale caktohen edhe mjeke specialiste zevendesues. Shperblimi i tyre behet mbi bazen e seancave qe ato marrin pjese.

5. Per te shqyrtuar kerkesat e te semureve dhe invalideve KMCAP-et Rajonale mblidhen jo me pak se tre here ne muaj, ndersa KMCAP-et Eprore jo me pak se njehere ne muaj. Per kete qellim, anetaret e KMCAP-ve per ditet qe jane ne komisione lirohen nga detyra e perditshme dhe punojne prane organeve te sigurimeve shoqerore.

Anetaret e KMCAP-ve Eprore aktivizohen me ekipe kontrolli cdo muaj.

## **II. Te Drejtat dhe Detyrat e KMCAP-ve**

1. Anetaret e KMCAP kane per detyre te njohin ligjin per sigurimet shoqerore dhe aktet e ndryshme nenligjore, kriteret mjekesore per caktimin e aftesise per pune te te semureve dhe invalideve dhe t'i zbatojne ato drejte, sakte e me pergjegjesi.

Para zhvillimit te seances anetaret e KMCAP-ve, studjojne praktiken me dokumentacionin e plotesuar sipas rregullores per caktimin, administrimin dhe pagimin e pensioneve, gjykojne nese plotesohen ose jo kushtet ligjore per perfitim, marrin te dhena per ecurine e semundjes, kohen e fillimit te invaliditetit profesionin, dhe kushtet e punes qe kryen i siguruari.

Mbi bazen e ketyre te dhenave nxjerrin nje konkluzion paraprak:

- a. rastet qe nuk plotesojne kushtet ligjore nuk shqyrtohen ne KMCAP-in dhe dokumentet i kthehen zyrtarisht kerkuesit.
- b. rastet qe plotesojne kushtet ligjore vlersohen nga KMCAP-i i cili pasi viziton te semurin merr vendim mbi shkallen e humbjes se aftesise per pune dhe sipas rastit jep rekomandime per riaftesimin fizik dhe profesional te tyre.

## **II/1. Te drejtat dhe detyrat e veçanta te KMCAP-it rajonal.**

Cakton drejte e ne perputhje me gjendjen shendetesore te invalideve dhe te semureve, si dhe ne mbeshtetje te kritereve mjekesore per caktimin e aftesise per pune te invalideve, shkallen e humbjes se aftesise per pune.

Cakton shkakun e invaliditetit nga semundje e pergjithshme, aksident ne pune ose semundje profesionale; kohen e fillimit te invaliditetit; periudhen e perfitimit, si dhe afatin e rikontrollit.

Cakton kushtet dhe karakterin e punes qe duhet te kryeje invalidi.

Cakton masat qe duhen marre per riaftesimin e plote fizik si dhe drejtimet per riaftesimin profesional te invalidit.

Kryen studime mbi gjendjen dhe ecurine e invaliditetit ne rajon.

## **II/2. Te drejta dhe detyra te veçanta te KMCAP-ve Eprore te specializuar.**

Shqyrton dhe zgjidh kerkesat e te semureve dhe invalideve, qe apelojne vendimet e KMCAP-it Rajonal, si dhe shqyrton dhe zgjidh rastet e derguara me divergjence nga KMCAP-et Rajonale.

Studjon praktikat e derguara nga DRSSH-te, merr masa per plotesimin e tyre, therret dhe viziton apeluesin ne mbledhjen e radhes dhe ne vartesi te shkakut te invaliditetit dhe gjendjes shendetesore merr vendim mbi shkallen e humbjes se aftesise per pune.

Kontrollon se bashku me mjeket e ISSH-se, aktivitetin e KMCAP-ve Rajonal dhe ben vleresime mbi punen e kryer. Kur evidenton shkelje te dispozitave ligjore, akteve nenligjore, si dhe te kritereve mjekesore orientuese per caktimin e aftesise per pune te invalideve, mban aktin perkates dhe merr masa per cdemtimin e fondeve. Sipas natyres dhe rendesise se shkeljeve ose urdheron KMCAP-in Rajonal qe te rikontrolloje invalidet dhe te rregulloje vendimet ku caktimi i aftesise per pune ka qene i kundraligjshem, ose organizon vete ne rajon ose ne ISSH, nje seance te veçante per rikontrollin e tyre. Ne keto raste, KMCAP-i per çdo individ te rikontrolluar, mer vendim te ri per shkallen e humbjes se aftesise per pune.

Kryen studime mbi gjendjen dhe ecurine e invaliditetit dhe cakton drejtimet dhe rruget per permiresimin e treguesve.

Persos vazhdimisht kriteret orjentuese mjekesore per caktimin e aftesise per pune te te semureve dhe invalideve.

## **III. Rregullat e drejtimit, menyra e shqyrtimit dhe marrja e vendimit ne Komisionin Mjekesor te Caktimit te Aftesise per Pune te Invalideve.**

1. Personat që drejtohen në KMCAP janë vetëm personat që plotësojnë kushtet sipas ligjit nr.7703, datë 11.05.1993 “Për Sigurimet Shoqërore në Republikën e Shqipërisë”. Ky drejtim behet :

Nga institucionet mjekësore me shtreter, kur i semuri drejtohet në KMCAP për here të pare, duke e pajisur me “Flete-Drejtimi për në KMCAP”. Paisja ose jo me këte dokument vendoset në viziten e përgjithshme ose në konferencën klinike të drejtuar nga shefi i klinikës ose shefi i shërbimit. Vendimi i marrë duhet të pasqyrohet edhe në kartelën klinike e të firmoset nga stafi, mjeku kurues, shefi i pavionit apo shefi i klinikës dhe në mungesë të tij shefi i shërbimit. “Flete-Drejtimi për në KMCAP” është dokumenti kryesor mjekësor, që pasqyron gjendjen shëndetësore dhe që jep të drejtën për t’u drejtuar në organet e sigurimeve shoqërore, për efekt përfitimi sipas ligjit për sigurimet shoqërore. Për këte arsye ai plotësohet saktë, qartë dhe me përgjegjësi nga mjeku kurues, duke iu përgjigjur plotësisht rubrikave që ka formati. Në përfundim ky dokument nënshkruhet me emër e mbiemrin e mjekut kurues, shefit të pavionit apo klinikës, shefit të shërbimit dhe drejtuesi i institucionit.

Nga Komisionet Mjekësore (KM), kur i semuri paraqitet për here të pare në KMCAP dhe vuan nga semundje të syve kirurgjikale, ortopedike dhe gjendje pas diegieve (raste që nuk përbejnë objekt trajtimi në institucionet me shtreter). Në këto raste leshohet “Flete-Drejtimi për në KMCAP”, që plotësohet saktë, qartë dhe me përgjegjësi, duke përmbushur të gjitha kërkesat e formatit.

Nga Spitali ose Komisioni Mjekësor, kur invalidi paraqitet para afatit të rikontrollit dhe pretendon për gjendje shëndetësore të rënduar, duke e pajisur me “Flete-Drejtimi për në KMCAP”.

Nga specialistet, konsultat ose spitali, kur invalidi paraqitet për rikontrollin e rradhës, duke e pajisur me “Epikrizë përcjellese”, që plotësohet saktë, qartë dhe me përgjegjësi, duke evidentuar gjendjen shëndetësore të invalidit nga kontrolli i fundit deri në rikontrollin e radhës. Në rikontroll, krahas epikrizës përcjellese, invalidet paisen edhe me analizë dhe ekzaminime që janë të domosdoshme, për evidentimin e plote të gjendjes shëndetësore të tij.

Në çdo rast që leshohet “Flete-Drejtimi për në KMCAP”, ai plotësohet me shkrim të lexueshem, me shkronja shtypi, pa korigjime.

2. I semuri që drejtohet për here të pare në KMCAP duhet të paraqesë në Agjensinë e Sigurimeve Shoqërore (pritja) dokumentet e nevojshme sic përcaktohet në Rregulloren në fuqi për caktimin, administrimin dhe pagimin e pensioneve.

3. Mjeku i ekspertizës merr nga Kryetari i Degës së Përfitimeve, praktiken e kompletuar sic përcaktohet në rregulloren në fuqi për caktimin, administrimin dhe pagimin e pensioneve, ben verifikimet e nevojshme të dokumentacionit mjekësor, e konsulton me KMCAP-in dhe brenda 10 ditëve cakton datën e paraqitjes të të semurit në KMCAP ose për gatit përgjigjen negative të argumentuar, në rast se kërkuesi nuk plotëson kushtet ligjore .

4. I semuri qe drejtohet per here te pare ne KMCAP, duhet qe me pare te kete perfituar pagese per periudhen e paaftesise te perkohshme ne pune sipas dispozitave te ligjit per sigurimet shoqerore.

KMCAP ne varesi te nozologjise dhe rastit, vendos per daten e fillimit te invaliditetit edhe pa plotesuar 6 muaj paaftesi te perkohshme ne pune per semundjet e pergjithshme dhe 1 vit per semundjet profesionale dhe aksidentet ne pune.

Nese perfiton invaliditet te plote i semuri duhet te kete konsumuar me pare periudhen prej 6 muaj te paaftesise se perkohshme per semundje te pergjithshme dhe 1 vit per semundjen profesionale/aksident ne pune.

Nese perfiton invaliditet te pjesshem, mund te perfitoje deri ne 6 muaj pagese per paaftesi te perkohshme nga semundje e pergjithshme, ose deri 12 muaj per aksidentet ne pune/ semundjet profesionale.

Te tjere, sipas nenit 2 pika "b" dhe nenit 3 te ligjit nr.7703, dt.11.05.1993, perfitojne invaliditet te plote pas perjudhes 6 mujore te paaftesise se perkohshme per pune (e papaguar).

5. Caktimi i aftesise per pune i te semurit behet nga KMCAP-i Rajonal, ku eshte i siguruar deri ne nje vit nga dita e fundit e sigurimit ose ku ka vendbanimin e tij, kur eshte shkeputur nga skema e sigurimit mbi nje vit.

6. Ne KMCAP i semuri ose invalidi paraqiten vetem ne daten e kontrollit qe caktohet nga mjeku i sigurimeve shoqerore, si dhe ne daten e rikontrollit, qe caktohet nga KMCAP gjate komisionimit te fundit. Kur per arsye te gjendjes shendetesore te rende, nuk mund te paraqitet ne KMCAP ne daten e caktuar atehere komisionimi i tij behet ne banese ose ne spitalin ku ndodhet i shtruar. Ne keto raste te afermit duhet te njoftojne KMCAP 15 dite para dates se paraqitjes ne komision, me ane te dokumentit te leshuar nga mjeku kurues (Epikrize-percjellese), e cila evidenton gjendjen e renduar, duke argumentuar edhe arsyen e pamundesise se paraqitjes ne KMCAP.

7. Komisionimi i te semureve dhe invalideve ne KMCAP behet brenda 30 diteve nga data e paraqitjes se dokumenteve.

Rikontrolli i invalideve ne KMCAP behet ne vartesi te gjendjes shendetesore dhe gjithmone dy muaj para mbarimit te afatit qe eshte marre ne vendimin e fundit.

Invalidet qe nuk paraqiten ne KMCAP ne daten e rikontrollit, ruajne te drejten e rishqyrtimit gjate periudhes tremujore ne vazhdim. Neqoftese paraqiten brenda kesaj periudhe te drejten e perfitimit e ruajne edhe per periudhen e prapambetur.

Ne qofte se invalidi nuk paraqitet ne KMCAP edhe gjate kesaj periudhe KMCAP, ne mbeshtetje te nenit 62 te Ligjit nr. 7703, date 11.05.1993 " Per Sigurimet Shoqerore", merr vendim dhe e deklaron ate pa invaliditet. Ne kete rast, dosja konsiderohet e mbyllur dhe per rihapjen e saj do te zbatohen te njejtat rregulla si per rastet qe drejtohen per here te pare.

Kur rihapet praktika, periudha e perfitimit do te jete nga data e rikontrollit ne KMCAP, pavaresisht se ka bere objekt per perfitime edhe per periudhen e prapambetur.

8. Rikontrolli i invalideve, rrjedhoje e nje semundje te pergjitheshme ose aksidenti ne pune apo semundje profesionale, si rregull do te behet ne afate jo me shume se nje vjecare.

Perjashtohen nga ky rregull invalidet me gjymtime fizike ose gjendje shendetesore te parikthyeshme, me pamundesi riaftesimi profesional (per shkak te moshes dhe nivelit arsimor), per te cilet afatet e rikontrollit mund te shtrihen deri ne 3 vjet. Te gjithe invalidet qe kane afat rikontrolli mbi nje vit duhet te paraqesin ne Agjensine e Sigurimeve Shoqerore perkatese certifikaten e lindjes.

Rikontrolli i invalideve qe me vendim te KMCAP-it futen ne rrugen e kualifikimit ose rikualifikimit, kursit ose shkolles per kualifikim dhe rikualifikim, do te behet i pervitshem deri sa te perfundoje ky proces. Nese ky proces deshton, rikontrolli i ktyre invalideve mund te behet nje here ne tre vjet.

9. Kur invalidi ploteson moshen per pension pleqerrie dhe nese paraqet kerkese per te vazhduar te marre pension invaliditeti, KMCAP-i ne varesi te shkalles se humbjes se aftesise ne pune dhe ecurise se semundjes, merr vendim per invaliditet te perhershem.

10. Kunder vendimit te KMCAP-it Rajonal, personi apelon ne KMCAP-in Epror te specializuar. Kerkesa eshte e vlefshme kur ajo behet brenda 30 diteve nga data e marrjes se vendimit nga KMCAP-i DRSSH-se. Kerkesa behet me shkrim dhe dorezohet ne DRSSH-se, kjo e fundit brenda 10 diteve e dergon ne Institutin e Sigurimeve Shoqerore praktiken se bashku me nje relacion te hollesishem qe argumenton vendimin e marre nga KMCAP- i Rajonal. Ky relacion firmoset dhe vuloset nga DRSSH-se

11. KMCAP-i Epror i specializuar detyrohet te komisionoje apeluesit brenda periudhes dy mujore, nga data e paraqitjes se dokumentave ne Institutin e Sigurimeve Shoqerore. Kur apeluesit nuk paraqiten ne keto komisione dy here radhazi, ne zbatim te nenit 62, KMCAP Epror merr vendim pa invaliditet dhe praktika i kthehet DRSSH-se perkatese. Ne kete rast praktika konsiderohet e mbyllur dhe per rihapjen e saj do te ndiqet procedura si per rastet qe paraqiten ne KMCAP per here te pare.

12. KMCAP-i ne çdo rast qe komisionon te semure ose invalide merr vendim per caktimin e aftesise se tyre per pune.

Vendimi eshte dokumenti baze juridiko-mjekesor-administrativ qe njeh te drejten per perfitime sipas shkalles se humbjes se aftesise per pune. Ai plotesohet sakte, drejte me pergjegjesi sipas kerkesave te formatit, me shkrim te lexueshem, pa korigjime, vertetohet me emrin dhe mbiemrin e anetareve te KMCAP, nenshkrimin e tyre si dhe vuloset me vulen e komisionit.

Vendimi ka fuqi ligjore ekzekutive kur eshte i nenshkuar nga te gjithe anetaret e KMCAP. Ne ato raste kur ndermjete anetareve te komisionit ka mendime te kunderta per shkallen e humbjes se

aftesise per pune te invalidit ose te semurit, vendimi merret me divergjence dhe anetari qe nuk eshte dakort me te tjeret argumenton ne kete vendimin arsyen e divergjences.

Ne keto raste vendimi mbetet pezull dhe se bashku me praktiken dergohet zyrtarisht ne KMCAP Epror te specializuar.

Kur anetaret e KMCAP Epror te specializuar kane mendime te kunderta per shkallen e humbjes se aftesise per pune te invalidit ose te semurit, vendimi merr formen e prere me shumice votash.

13. Vendimi i KMCAP Epror te specializuar ka forme te prere per invalidin ose te semurin. Ai nuk mund te ndryshohet nga KMCAP i rajonit brenda afatit te shenuar ne vendimin e KMCAP Epror te specializuar. Ne ato raste kur KMCAP-i DRSSH-se gjykon se invalidi paraqet gjendje shendetesore te renduar dhe ben objekt per te ndryshuar aftesine per pune, ai merr vendim duke argumentuar edhe arsyen e ketij ndryshimi. Por ne keto raste, pavaresisht nga vendimi i KMCAP-i te DRSSH-se, vendimi do te marre forme te prere vetem mbas miratimit te KMCAP Epror te specializuar.

#### **IV. ADMINISTRIMI I DOKUMENTAVE**

1. Dokumentet e invalidit sistemohen ne praktiken e tij te veçante, mbahen dhe ruhen ne arshiven e pensioneve te invaliditetit ne DRSSH-te.

2. Per evidentimin e te semureve qe drejtohen per here te pare ne KMCAP-in Rajonal, mjeku i ekspertizes mban nje regjister te veçante, ku regjistron daten e marrjes ne dorezim te praktikes, daten e planifikuar per komisionim ose daten e refuzimit te kerkeses dhe argumentin e refuzimit.

3. Evidentimi i te gjitha te dhenave qe ka vendimi i KMCAP-it behet ne nje regjister te veçante.

Vendimi, ne çdo rast, plotesohet gjate seances se KMCAP-it, mbas vizites mjekesore dhe shqyrtimit te dokumentacionit plotesues te invalidit ose te semurit.

Krahas plotesimit te vendimit, KMCAP-i, ploteson edhe vertetimin, i cili permban shkurtazi te dhenat kryesore te vendimit. Vendimi i KMCAP-it, nepermjet vertetimit, i komunikohet invalidit ose te semurit vetem nga Kryetari i KMCAP-it.

Forma e permbajtja e ketyre dokumenteve miratohen nga Instituti i Sigurimeve Shoqerore.

4. Personeli mjekesor, anetaret e Komisionit Mjekesor, si dhe anetaret e KMCAP-it qe me veprimet e tyre demtojne fondet e sigurimeve shoqerore, mbajne pergjegjesi disiplinore, pergjegjesi materiale, pergjegjesi penale.

Anetaret e KMCAP-it qe ne veprimtarine e tyre veprojne ne kundershtrim me normat e caktuara dhe demtojne fondet e sigurimeve shoqerore, denohen me gjobe ne masen nga tre deri ne pese fishin e pages minimale ne shkalle vendi caktuar me VKM. Gjoba vendoset nga personeli i ISSH, pergjegjes per paaftesine e perkohshme, barre lindjen dhe ekspertizen mjekesore

Kunder vendimit te gjobes behet ankim brenda 30 diteve nga data e njoftimit, tek Drejtori i Pergjithshem i ISSH, i cili le ne fuqi, anullon ose ndryshon masen e gjobes.

5. Me kontrollin e zbatimit te kesaj rregullore ngarkohen organet e sigurimeve shoqerore dhe organet drejtuese te institucioneve shendetesore.

6. Rregullorja date 13.07.1995 e ISSH-se dhe Ministrise se Shendetesise dhe Mbrojtjes se Mjedisit "Per organizimin, te drejtat, detyrat dhe funksionimin e KMCAJ" shfuqizohet.

7. Kjo rregullore hyn ne fuqi me 30.05.2005

**INSTITUTI I SIGURIMEVE  
SHOQËRORE**

**MINISTRIA E SHËNDETËSISË**

**KRYETARI**

**MINISTRI**

**KESHILLIT ADMINISTRATIV**

**Leonard SOLIS**

**Engjell BEJTAJ**